

“By This All Will Know That You Are My Disciples”

By Elder Dieter F. Uchtdorf
Of the Quorum of the Twelve Apostles

“Prej Kësaj Do t’ju Njohin të Gjithë që Jeni Dishepujt e Mi”

Nga Plaku Diter F. Uhtdorf,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

April 2025 general conference

Our love for God and His children is a powerful testimony to the world that this is truly the Savior’s Church.

Many years ago Sister Uchtdorf and I were traveling through southern Germany. It was just before Easter, and we invited a good friend, who was not a member of the Church, to join us in our Sunday worship service. We loved this dear friend, so it was normal and natural to share with her how we felt about the Savior and His Church and to invite her to come and see! She accepted the invitation and joined us at the meetings of a nearby branch.

If you have ever brought a friend to church for the first time, you can probably relate to the way I felt that Sunday morning. I wanted everything to go perfectly. Our friend was a highly educated, spiritual person. I earnestly hoped the meetings of this branch would make a good impression on her and represent the Church well.

The branch met in some rented rooms on the second floor of a grocery store. To get there, we had to take the stairs at the back of the building, passing the strong aromas from goods stored there.

As the sacrament meeting began, I thought about my friend experiencing this for the first time, and I couldn’t help but notice things that made me cringe a little. The singing, for example, didn’t exactly sound like the Tabernacle Choir. Restless, noisy children could be heard during the sacrament. The speakers did their best, but they were not skilled at public speaking. I sat uncomfortably through the meeting, hoping that

Dashuria jonë për Perëndinë dhe për fëmijët e Tij është një dëshmi e fuqishme për botën që kjo është vërtet Kisha e Shpëtimtarit.

Shumë vjet më parë, unë dhe Motra Uhtdorf po udhëtonim nëpër Gjermaninë jugore. Ishte periudha pak para Pashkës dhe ftuam një mike të mirë, e cila nuk qe anëtare e Kishës, të na bashkohej në shërbesën tonë të adhurimit të së dielës. Ne e donim këtë mike të shtrenjtë, ndaj ishte normale dhe e natyrshme që t’i tregonim si ndiheshim rreth Shpëtimtarit dhe Kishës së Tij dhe ta ftonim që të vinte e të shihte! Ajo e pranoi ftesën dhe na u bashkua në mbledhjet e një dege aty pranë.

Nëse keni sjellë ndonjëherë një mik në kishë për herë të parë, mbase mund ta kuptoni se si ndihesh unë atë të diel në mëngjes. Doja që gjithçka të shkonte përsosurisht. Mikja jonë ishte një njeri tejet i arsimuar dhe shpirtëror. Shpresoja seriozisht që mbledhjet e kësaj dege t’i linin një përshtypje të mirë dhe ta përfaqësonin mirë Kishën.

Dega mbledhej në disa dhoma të marra me qira, në katin e dytë të një ushqimoreje. Për të shkuar atje, duhej të ngjitnim shkallët në anën e pasme të ndërtesës, duke ndier aromat e forta të artikujve që mbaheshin aty.

Kur filloi mbledhja e sakramentit, mendova për miken time që po e përjetonte këtë për herë të parë dhe nuk munda të mos vija re gjëra që më vunë në siklet. Kur njerëzit këndonin, për shembull, nuk tingëllonin dhe aq si Kori i Tabernakullit. Gjatë sakramentit dëgjoheshin fëmijë të paqetë e të zhurmshëm. Folësit bënë më të mirën, por nuk e kishin zotësinë e të folurit në publik. Qëndrova ulur plot siklet gjatë mbledhjes,

maybe Sunday School would be better.

It wasn't.

All morning I worried about what our friend must think of this church we had taken her to.

Afterward, as we drove home, I turned to talk to our friend. I wanted to explain that this was just one small branch and it didn't really represent the Church as a whole. But before I could say a word, she spoke up.

"That was beautiful," she said.

I was speechless.

She continued, "I'm so impressed with how people treat each other in your church. They all seem to come from different backgrounds, and yet it's clear that they genuinely love each other. This is what I imagine Christ wanted His Church to be like."

Well, I quickly repented of my judgmental attitude. I had wanted picture-perfect meetings to impress my friend. But what the members of this branch had achieved was a heart-perfect spirit of love, kindness, patience, and compassion.

That Faith Might Increase in the Earth

My dear brothers and sisters, my dear friends, I love The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints. It is the Savior's true and living Church, and it teaches the restored fulness of the gospel of Jesus Christ. His priesthood power and authority reside here. Jesus Christ leads this Church personally, through servants He has called and authorized, and by a living prophet, even President Russell M. Nelson. The Savior has given the Latter-day Saints a unique mission to gather God's children and prepare the world for the Savior's Second Coming. I bear my witness that all of this is true.

But it's important to remember that when most people experience the Church of Jesus Christ for the first time, they aren't thinking about priesthood authority or ordinances or the gathering of Israel. What they're likely to notice, above all else, is how they feel when they're with us and how we treat each other.

duke shpresuar se ndoshta Shkolla e së Dielës do të shkonte më mirë.

Nuk ndodhi.

Gjithë mëngjesin u shqetësova për atë që duhej të kishte menduar mikja jonë për këtë kishë ku e kishim çuar.

Paskëtaj, ndërsa shkonim me makinë për në shtëpi, u ktheva për t'i folur mikes sonë. Doja t'i shpjegoja që kjo ishte veç një degë e vogël dhe në të vërtetë nuk e përfaqësonte Kishën si të tërë. Po përpara se të thosha një fjalë, e mori ajo fjalën.

"Ishte bukur", – tha ajo.

Mbeta pa fjalë.

Ajo vazhdoi: "Më bëri shumë përshtypje se si e trajtojnë njerëzit njëri-tjetrin në kishën tuaj. Duket se të gjithë vijnë nga formime të ndryshme dhe prapëseprapë është e qartë që ata e duan çiltërsisht njëri-tjetrin. Kështu e imagjinoj se Krishti donte që të ishte Kisha e Tij."

Epo, u pendova shpejt për qëndrimin tim gjykues. Kisha dëshiruar mbledhje të përsosura si për kartolinë, që t'i linin mbresë mikes sime. Por ajo që kishin arritur anëtarët e kësaj dege, ishte një frymë dashurie, dashamirësie, durimi dhe dhembshurie, e përsosur për zemrën.

"Që Besimi ... të Mund të Rritet në Tokë"

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, miq të mi të dashur, unë e dua Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Ajo është Kisha e vërtetë dhe e gjallë e Shpëtimtarit dhe na mëson plotësinë e rivendosur të ungjillit të Jezu Krishtit. Fuqia dhe autoriteti i priftërisë së Tij banojnë këtu. Jezu Krishti e udhëheq Kishën e Tij vetë, nëpërmjet shërbëtorëve që Ai i ka thirrur dhe autorizuar, dhe nëpërmjet një profeti të gjallë, madje Presidentit Rasëll M. Nelson. Shpëtimtari u ka dhënë shenjtorëve të ditëve të mëvonshme një mision të pasqorë që t'i mbledhin fëmijët e Perëndisë dhe ta përgatitin botën për Ardhjen e Dytë të Shpëtimtarit. Jap dëshminë time se e gjitha kjo është e vërtetë.

Por është e rëndësishme të mbajmë mend se kur shumica e njerëzve e përjeton Kishën e Jezu Krishtit për herë të parë, ata nuk mendojnë rreth autoritetit të priftërisë, ordinancave apo mbledhjes së Izraelit. Ajo që më gjasë do të vënë re më shumë se gjithçka tjetër, është mënyra se si ndihen kur janë me ne dhe mënyra se si e trajtojmë njëri-tjetrin.

“Love one another,” Jesus said. “By this all will know that you are My disciples.” Very often, a person’s first testimony of Jesus Christ comes when he or she feels love among disciples of Jesus Christ.

The Savior declared that He restored His Church so “that faith ... might increase in the earth.” Therefore, when people visit our Church meetings, the Savior wants them to leave with stronger faith in Him! The love our friends feel among us will lift them closer to Jesus Christ! That is our simple goal every time we gather.

Anyone who is seeking greater faith in Christ or a closer connection to Heavenly Father should feel right at home in The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints. Inviting them to our meetings can be as normal and as natural as inviting them into our homes.

The Ideal and the Real

Now, I realize that I’m describing the ideal. And in this mortal life, we rarely get to experience the ideal. And “until the perfect day,” there will always be a gap between the ideal and the real. So, what should we do when the Church doesn’t feel like the perfect day? When, for whatever reason, our ward doesn’t yet nurture perfect faith or love? Or when it feels that we don’t fit in?

One thing we should not do is give up on the ideal!

The title page of the Book of Mormon includes this important caution: “If there are faults,” it says, “they are the mistakes of men; wherefore, condemn not the things of God.”

Can a book—or a church or a person—have “faults” and “mistakes” and still be the work of God?

My answer is a resounding yes!

So, while we hold ourselves to the Lord’s high standards, let’s also be patient with one another. We are each a work in progress, and we all rely on the Savior for any progress we make. That’s true for us as individuals, and it’s true for the kingdom of God on earth.

The Lord invites us not just to join His kingdom but also to be anxiously engaged in building it. God envisions a people who are “of one heart and one mind.” And to be of one heart, we must

“Ta doni njëri-tjetrin”, – tha Jezusi. “Prej kësaj do t’ju njohin të gjithë që jeni dishepujt e mi.” Shumë shpesh, dëshmia e parë e një njeriu për Jezun Krishtin, vjen kur ai ose ajo e ndien dashurinë mes dishepujvetë Jezun Krishtit.

Shpëtimtari deklaroi se Ai e rivendosi Kishën e Tij në mënyrë “që besimi ... të mund të rritet në tokë”. Prandaj, kur njerëzit i vizitojnë mbledhjet e Kishës sonë, Shpëtimtari do që ata të largohen me besim më të fortë tek Ai! Dashuria që miqtë tanë ndiejnë midis nesh, do t’i lartësojë ata duke i afruar më shumë me Jezun Krishtin. Ai është synimi ynë i thjeshtë sa herë që mbledhemi.

Kushdo që po kërkon besim më të madh te Krishti ose një lidhje më të afërt me Atin Qielor, duhet të ndihet si në shtëpi në Kishën e Jezun Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. T’i ftojme ata në mbledhjet tona mund të jetë po aq normale dhe e natyrshme sa po t’i ftojme në shtëpinë tonë.

Idealja dhe Realja

Tani, e kuptoj se po përshkruaj situatën ideale. Dhe, në këtë jetë në vdekshmëri, rrallëherë arrijmë ta përjetojmë idealen. Dhe “derisa dita [të je] të e plotë” në përsosuri, do të ketë gjithnjë një hendek mes idealeve dhe realeve. Pra, çfarë duhet të bëjmë kur Kishanukna duket si dita e përsosur? Kur, për çfarëdo arsye, lagjia jonë nuk e kultivon ende besimin ose dashurinë e përsosur? Ose kur ndiejmë se nuk përshtatemi me vendin aty?

Diçka që nuk duhet të bëjmë, është të heqim dorë nga idealja!

Faqja e titullit e Librit të Mormonit përfshin këtë paralajmërim të rëndësishëm: “Në qoftë se ka gabime”, – thuhet aty, – “ato janë gabime të njerëzve; prandaj mos dënoni gjërat e Perëndisë”.

A mundet një libër, ose një kishë apo një njeri, të ketë “gabime” dhe prapëseprapë të jetë vepër e Perëndisë?

Përgjigjja ime është një përkumbues!

Pra, ndërkohë që vetë përpiqemi të mbajmë standardet e larta të Zotit, le të jemi gjithashtu të duruar me njëri-tjetrin. Secili prej nesh është një vepër në punë e sipër, dhe të gjithë mbështetemi te Shpëtimtari për çdo përparim që bëjmë. Kjo është e vërtetë për ne si individë dhe është e vërtetë për mbretërinë e Perëndisë në tokë.

Zoti na fton që jo vetëm t’i bashkohemi mbretërisë së Tij, por edhe të përfshihemi me zell në ndërtimin e saj. Perëndia përfytyron një popull që është “[i] një zemër dhe [i] një mendje”. Për

seek pure hearts, and that requires a mighty change of heart.

But that doesn't mean changing my heart to align with yours. Nor does it mean changing your heart to align with mine. It means that we all change our hearts to align with the Savior.

If we are not there yet, remember: with the Lord's help, nothing is impossible.

Fit and Belonging

And if you ever feel like you don't quite fit in, please know that you are not alone. Haven't we all been in life situations when we felt like the stranger in the room? I have experienced this more than once. When I was 11 years old, my family was forced to leave our home and move to an unfamiliar region. Everything was different from what I was used to. And my accent made it clear to the other children that I was different from what they were used to. At a time when I desperately needed friendship and belonging, I felt lonely and displaced.

Here on earth, most of the differences we notice—the differences some of us use to categorize each other—have to do with earthly things: physical appearance, nationality, language, clothing, customs, and so on. But “God does not view things the way people do. People look on the outward appearance, but the Lord looks at the heart.”

From His perspective, there is one category that comes before all others: child of God. And we all fit perfectly in this one.

It's natural to want to be around people who look, talk, act, and think like we do. There is a place for that.

But in the Savior's Church, we gather all of God's children who are willing to be gathered and who seek the truth. It is not our physical appearance, our political views, our culture, or our ethnicity that brings us together. It is not our common background that unites us. It is our common objective, our love for God and love for our neighbor, our commitment to Jesus Christ and His restored gospel. We are “one in Christ.”

të qenë të njëzëmre, duhet të synojmë të kemi zemra të kulluara, dhe kjo kërkon njëndryshim të madh të zemrës.

Por kjo nuk do të thotë që ta ndryshoj zemrën time që të përputhet me tuajën. Nuk do të thotë as që ta ndryshoni zemrën tuaj që të përputhet me timen. Do të thotë që të gjithë e ndryshojmë zemrën që të na përputhet me Shpëtimtarin.

Nëse nuk jemi ende në atë pikë, mbajeni mend: me ndihmën e Zotit, asgjë s'është e pamundshme.

Përshtatja dhe Përkatësia

Dhe nëse ndonjëherë ndieni sikur nuk përshtateni aq me vendin aty, ju lutemi, dini se nuk jeni vetëm. A nuk kemi qenë të gjithë në situata të jetës ku jemi ndier si të huaj në dhomë? E kam përjetuar këtë më shumë se një herë. Kur isha 11 vjeç, familja ime u detyrua të linte shtëpinë dhe të shpërngulej në një krahinë të panjohur. Gjithçka ishte ndryshe nga ajo me të cilën isha mësuar. Theksi im ua bënte të qartë fëmijëve të tjerë që unë isha ndryshe nga ajo me të cilën qenë mësuara. Në një kohë kur kisha nevojë të skajshme për miqësi dhe përkatësi, u ndjeva i vetmuar dhe që nuk e kisha vendin aty.

Këtu në tokë, shumica e ndryshimeve që vëmë re, ndryshime që disa prej nesh i përdorin për të kategorizuar njëri-tjetrin, kanë të bëjnë me gjëra tokësore: pamja fizike, kombësia, gjuha, veshja, zakonet e kështu me radhë. Por “Perëndia nuk i sheh gjërat siç i shohin njerëzit. Njerëzit shikojnë pamjen, kurse Zoti shikon zemrën.”

Nga këndvështrimi i Tij, është një kategori që vjen përpara gjithë të tjerave: të qenit fëmijë i Perëndisë. Dhe në këtë kategori përshtatemi të gjithë përsosurisht.

Është e natyrshme të duam të jemi pranë njerëzve që duken, flasin, veprojnë dhe mendojnë si ne. Ka vend [dhe] për këtë.

Por në Kishën e Shpëtimtarit, mbledhim të gjithë fëmijët e Perëndisë që janë të gatshëm të mblidhen dhe që kërkojnë të vërtetën. Nuk është pamja jonë fizike, pikëpamjet tona politike, kultura jonë apo etnia jonë ajo që na bën bashkë. Nuk është formimi ynë i njëjtë ai që na bashkon në unitet. Është objektivi ynë i përbashkët, dashuria jonë për Perëndinë dhe dashuria jonë për të afërmin, zotimi ynë ndaj Jezu Krishtit dhe ungjillit të Tij të rivendosur. Ne jemi “një në ...

The unity we seek is not to have everyone stand in the same place; it is to have everyone face in the same direction—toward Jesus Christ. We are one not because of where we've been but where we are striving to go, not because of who we are but who we seek to become.

That is what Christ's true Church is all about.

One Body

If you love God, if you want to know Him better by following His Son, then you belong here. If you're earnestly seeking to keep the Savior's commandments—even though you're not perfect at it yet—then you are a perfect fit for The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints.

And what if you're different from people around you? That doesn't make you a misfit—it makes you a needed part of the body of Christ. All are needed in the body of Christ. The ears perceive things that the eyes never could. The feet do things that the hands would be ineffective at.

That doesn't mean your job is to change everyone to be like yourself. But it does mean that you have something important to contribute—and that you have something important to learn!

One Voice

In every session of general conference, we're blessed with inspiring music from talented choirs. As you listen, you might notice that the singers don't all sing the same notes. Sometimes one section carries the melody, sometimes another. But they all contribute to the beautiful sound, and they're completely unified. Each choir member has the same central goal: to praise God and lift our hearts to Him. Each must have his or her mind and heart fixed on the same divine purpose. And when that happens, they truly become one voice.

If you are not yet a member of The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints, we invite you to join us as we rejoice in the Savior's "song of redeeming love." We need you. We love you. The Church will be better with your efforts to serve the Lord and His children.

Krishtin".

Uniteti që synojmë, nuk është që të gjithë të kenë të njëjtin qëndrim; është që të gjithë të shohin në të njëjtin drejtim, atë të Jezu Krishtit. Ne jemi një, jo për shkak të asaj që kemi kaluar, por se ku po përpiqemi fort të shkojmë; jo për shkak të asaj që jemi, por të asaj që synojmë të bëhemi.

Ky është gjithë qëllimi në Kishën e vërtetë të Krishtit.

Një Trup

Nëse e doni Perëndinë, nëse doni ta njihni më mirë Atë duke ndjekur Birin e Tij, atëherë ju e keni vendin këtu. Nëse po kërkonim me zell t'i mbani urdhërimet e Shpëtimtarit, ndonëse nuk jeni përsosur ende në bërjen e kësaj, atëherë ju jeni plotësisht të përshtatshëm për të qenë në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

Dhe, po sikur të jeni ndryshe nga njerëzit përreth jush? Kjo nuk ju bën ju të papërshtatshëm, ju bën një pjesë të nevojshme të trupit të Krishtit. Të gjithë janë të nevojshëm në trupin e Krishtit. Veshët rrokin gjëra që sytë nuk do të mundeshin kurrë t'i rroknin. Këmbët bëjnë gjëra që duart nuk do të arrinin dot t'i bënin.

Kjo nuk do të thotë se detyra juaj është ta ndryshoni çdokënd që të jetë si ju. Por kjo do të thotë vërtet se ju keni diçka të rëndësishme me të cilën të kontribuoni, dhe se keni diçka të rëndësishme për të mësuar!

Një Zë

Në çdo sesion të konferencës së përgjithshme, bekohemi me muzikë frymëzuese nga kore të talentuara. Ndërsa mbani vesh, mund të vini re se jo të gjithë këngëtarët këndojnë të njëjtat nota. Nganjëherë, melodinë e mban njëra pjesë e korit, nganjëherë një tjetër. Por të gjithë ata bëjnë pjesën e tyre për të krijuar tingullin e bukur dhe janë në unitet të plotë. Secili anëtar i korit ka të njëjtin synim kryesor: t'i thurë lavde Perëndisë dhe të na ngrejë zemrën peshë për tek Ai. Secili duhet ta ketë mendjen dhe zemrën e vet të ngulitur tek i njëjti qëllim hyjnor. Dhe kur kjo ndodh, ata vërtet bëhen një zë i vetëm.

Nëse nuk jeni ende anëtar/e i/e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, ju ftojmë të na bashkoheni teksa gëzohemi në "këngën e dashurisë shëlbuese" të Shpëtimtarit. Kemi nevojë për ju. Ju duam. Kisha do të jetë më e mirë me përpjekjet tuaja për t'i

If you have already shown, through baptism, through making covenants with God, your desire to “come into the fold of God, and to be called his people,” thank you for being part of this great and divine work and for helping to make the Church of Jesus Christ what the Savior wants it to be.

As I learned from my friend in Germany, our love for God and His children is a powerful testimony to the world that this is truly the Savior’s Church.

May God bless us to patiently but diligently seek to live up to the ideals our Savior, Redeemer, and Master has set for us—so all will know that we are His disciples. In the sacred name of Jesus Christ, amen.

shërbyer Zotit dhe fëmijëve të Tij.

Nëse e keni treguar tashmë, nëpërmjet pagëzimit, nëpërmjet bërjes së besëlidhjeve me Perëndinë, dëshirën tuaj që të “hyni në grigjiën e Perëndisë dhe të quheni populli i tij”, faleminder-it që jeni pjesë e kësaj veprë të madhërishe e hyjnore dhe që po ndihmoni për ta bërë Kishën e Jezu Krishtit ashtu sikurse Shpëtimtari dëshiron që ajo të jetë.

Sikurse e mësova nga mikja ime në Gjermani, dashuria jonë për Perëndinë dhe për fëmijët e Tij është një dëshmi e fuqishme për botën që kjo është vërtet Kisha e Shpëtimtarit.

Perëndia na bekoftë që të synojmë me durim dhe me zell që të jetojmë në lartësinë e idealeve të cilat Shpëtimtari, Shëlbuesi dhe Mësuesi ynë ka vendosur për ne, në mënyrë që të gjithë do të na njohin se ne jemi dishepujt e Tij. Në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen.